



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 10.07 20 25		
Priljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-400/02-34,955		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

10.07.2025

Zyra e kryetarit të komunës

PROCESVERBALET E ORGANIZIMEVE TË DËGJIMEVE BUXHETORE PËR KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2026–2028



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028

Data: 10.06.2025

Ora: 13:30

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Takimi i Parë: Përfaqësuesit e Kuvendit Komunal dhe Komitetet

Numri i pjesëmarrësve: 18

Burra: 12

Gra: 6

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjate këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka bërë prezantimin e planifikimit të buxhetit të komunës së Lipjanit duke i falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e parë për kornizën afatmesme buxhetore 2026 – 2028 me theks të veçantë investimet kapital dhe investimet tjera të cilat do të bëjë komuna për gjate viteve 2026 – 2028.

Diskutimet:

Lulzim Rustemi

Vlerësoi Kornizën si hap të parë të planifikimit. Theksoi nevojën për investime në furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizim të ujërave të zeza, sidomos në bashkëpunim me Prishtinën për impiantin e përbashkët të trajtimit të ujërave.

Sugjeroi përfshirjen në buxhet të ndriçimit publik, trotuareve dhe asfaltimeve në rrugët dytësore të papërfshira deri më tani.

Gentian Hoxha

Kërkoi që në buxhet të përfshihet:

Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Topliqan



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Rrethojat e shkollës dhe asfaltimi i rrugicave në Topliqan

Rruga Topliqan–Kojске si projekt i domosdoshëm

Rinor Murati

Sugjeroi rregullimin e ndriçimit publik dhe asfaltimin e rrugicave në Kojске, Ribovc.

Përmendi problematikën pronësore në lagjen “Akllapti” dhe nevojën për shtruarje minimale të rrugëve.

Shtroi nevojën për ndërtimin e një objekti të ri shkollor në qytet.

Bardhyll Ibrahim, kryetar i fshatit Glllogoc

U shpreh se për herë të parë merr pjesë në dëgjim publik dhe theksoi mungesën e përfaqësimit të fshatit në Kuvendin Komunal.

Paraqiti shqetësimin për rritjen e urës mbi hekurudhë që po shkakton kthim të ujërave në lagje.

Latif Ramadani, për Buxhete dhe Financa

Sqaroi se Komuna nuk mund të ndërhyjë në projekte që janë jashtë kompetencave të saj, si në rastin e ndërhyrjes në hekurudhë.

Theksoi se çdo kërkesë do të shqyrtohet dhe se buxheti do të planifikohet në mënyrë sa më të balancuar për të gjitha fshatrat.

Nënvizoi se janë duke u mbledhur propozimet për vitet 2026–2028, ndërsa projektet për vitin aktual janë në implementim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028

Data: 10.06.2025

Ora: 14:30

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Takimi i Dytë: Gratë dhe shoqatat e grave

Numri i pjesëmarrësve: 26

Burra: 5

Gra: 21

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjate këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka bërë prezantimin e planifikimit të buxhetit të komunës së Lipjanit duke i falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e pare për kornizën afatmesme buxhetore 2026 – 2028 me thekës të veçante investimet kapital dhe investimet tjera të cilat do ti bëj komuna për gjate viteve 2026 – 2028.

Diskutimet:

Vlora Krasniqi

Kërkoi që të shqyrtohet mundësia e shpronësimit të pronave private në lagjen Akllap, me qëllim asfaltimin e rrugëve që janë me rëndësi për qytetarët.

Latif Ramadani, Drejtori për Buxhete dhe Financa

Sqaroi se procesi i shpronësimit është shumë i kushtueshëm dhe aktualisht nuk ka marrëveshje me pronarët për fillimin e punimeve, megjithatë komuna ka gatishmëri për bashkëpunim nëse gjendet një zgjidhje ligjore.

Bekim Krasniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Kërkoi që të subvencionohen organizimet e panairove për gratë me qëllim të promovimit të produkteve ose prodhimeve të tyre.

Latif Ramadani, Drejtori për Buxhete dhe Financa

Siguroi se të gjitha kërkesat që vijnë nga drejtoritë përkatëse do të shqyrtohen gjatë hartimit të KAB dhe se jemi ende në fazën fillestare të këtij procesi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028

Data: 10.06.2025

Ora: 15:30

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Takimi i tretë: Organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit

Numri i pjesëmarrësve: 32

Burra: 30

Gra: 2

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjate këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka bërë prezantimin e planifikimit të buxhetit të komunës së Lipjanit duke i falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e pare për kornizën afatmesme buxhetore 2026 – 2028 me thekës të veçante investimet kapital dhe investimet tjera të cilat do ti bëj komuna për gjate viteve 2026 – 2028.

Diskutimet:

Bekim Krasniqi (përfaqësues i organizatës joqeveritare),

Shprehu interesimin nëse ka ndonjë rritje të buxhetit për subvencione në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe nëse ato janë të ndara sipas kategorive.

Imri Laça,

Pyeti nëse subvencionet ndahen në kategori të ndryshme apo në një kategori të vetme.

Abedin Hazrolli (Shkolla e Futbollit “Minatori”, Magure),

Theksoi se mbështetja prej 1,500 eurosh është e pamjaftueshme, duke pasur parasysh shpenzimet që shkollat e futbollit kanë. Kërkoi rritje të mbështetjes për këto shkolla.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Tefik Retkoceri (trajner i hendbollit),

Falënderoi Komunën për përkrahjen aktuale, por kërkoi që subvencionet të mos vonohen, për shkak të nevojave operacionale të ekipeve sportive.

Ragip Mehmeti,

Propozoi që në buxhet të ndahen mjete për mirëmbajtjen e lapidarëve.

Latif Ramadani, Drejtori për Buxhete dhe Financa,

Informoi se projektet për mirëmbajtjen e rrugëve të kategorisë së katërt janë duke u implementuar dhe pritet të përfundojnë në vitin 2026. Sipas tij, rritja e të hyrave komunale po krijon mundësi për rritje të subvencioneve për klubet sportive dhe gratë.

Rinor Murati,

E vlerësoi angazhimin e komunitetit sportiv dhe kërkoi renovimin e sallës “Beterlafi” në Lipjan.

Bekim Krasniqi,

Propozoi ndarjen e një kodi buxhetor për riparimin dhe mirëmbajtjen e fushave të hapura sportive në qytet dhe fshatra.

Imri laça (përfaqësues i klubit të volejbollit “Skënderbeu”),

Kërkoi kategorizimin e klubeve sportive në bazë të nivelit të garimit, pasi është e padrejtë që të gjithë klubet të subvencionohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht rezultateve. Propozoi krijimin e një komisioni vlerësues.

Anila Reçica Llugini (Drejtoreshë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit),

Informoi se kategorizimi ndodh për çdo thirrje publike, ku çdo klub është i obliguar të dorëzojë dokumentacionin përkatës për nivelin e garimit. Në bazë të këtij kategorizimi, përcaktohet edhe mbështetja financiare.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028

Data: 10.06.2025

Ora: 16:30

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Takimi i katërt: Qytetarët e Lipjanit

Numri i pjesëmarrësve: 13

Burra: 12

Gra: 1

Në kuadër të procesit të dëgjimeve publike për Kornizën Afatmesme të Buxhetit të Komunës së Lipjanit, është mbajtur takimi i radhës me qytetarët e Lipjanit.

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjate këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka bërë prezantimin e planifikimit të buxhetit të komunës së Lipjanit duke i falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e pare për kornizën afatmesme buxhetore 2026 – 2028 me theks të veçante investimet kapital dhe investimet tjera të cilat do të bëjë komuna për gjate viteve 2026 – 2028.

Diskutimet:

Gëzim Bytyqi,

Ngriti çështjen e ndërtesave kolektive (banesave në bashkëpronësi), duke kërkuar që të merren parasysh përfshirja e tyre në projektet për efikasitet energjetik, përmes ndonjë granti të mundshëm. Lidhur me ndërtimin e shtëpisë së kulturës, ai propozoi që të parashihet ndërtimi i një parkingu nëntokësor në atë zonë, duke theksuar nevojën që ka Komuna për hapësira të tilla. Ndër të tjera, ai pyeti nëse granti për efikasitet energjetik përfshin edhe këto objekte kolektive.

Bekim Krasniqi,

Propozoi hapjen e një kopshti apo çerdheje të re në qytet.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Latif Ramadani, Drejtori për Buxhete dhe Financa

Drejtori theksoi se nëse ekziston marrëveshja me palët për rrugën në lagjen Dardania, ajo mund të futet në agjendën buxhetore të Komunës. Ai shtoi se Komuna posedon një kod buxhetor për bashkëfinancim, dhe se disa ndërtesa tashmë janë përfshirë në projekte të mëhershme për renovim. Për fat të keq, për shkak të mungesës së mbështetjes financiare nga Ministria përkatëse, nuk ka qenë e mundur të vazhdohet me të gjitha projektet. Ai theksoi se, sapo të sigurohen fonde përmes donacioneve, projektet do të vazhdojnë. Sa i përket grantit për efikasitet energjetik, ai bëri të ditur se një pjesë e tij ka qenë e dedikuar për shkolla, ndërsa për banesat kolektive është zbatuar në kuadër të programit për efikasitet nga Fondi i Mileniumit.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028

Data: 10.06.2025

Ora: 19:00

Vendi: Shkolla Fillore “Zenel Hajdini”, Gadime

Takimi i pestë: Qytetarët e Gadimes

Numri i pjesëmarrësve: 35

Burra: 32

Gra: 3

Në kuadër të dëgjimeve publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028, është mbajtur takim me banorët e fshatit Gadime, me pjesëmarrje të zyrtarëve komunalë dhe qytetarëve të interesuar.

Prezantimi:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, z. Latif Ramadani

Takimin e hapi drejtori për Buxhet dhe Financa, i cili prezantoi pikat kyçe të Kornizës Afatmesme Buxhetore, me theks të veçantë në planifikimin e investimeve kapitale për vitet në vijim.

Pjesëmarrës në këtë takim ishte edhe Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti, i cili elaboroi më tej buxhetin komunal, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve në identifikimin e nevojave specifike, me qëllim që të ndërtohet një buxhet gjithëpërfshirës dhe realist.

Diskutimet:

Nexhmedin Lekiqi,

Vlerësoi punët e deritanishme në Gadime dhe kërkoi vazhdimin e investimeve.

Kërkoi zgjerimin dhe adaptimin e katër urave në fshat.

Propozoi rregullimin e rrugës që lidh Gadimen e Epërme me Gllavicën.

Mustaf Rexhepi,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Kërkoi rregullimin e shtratit të lumit në një segment të pandërhyrë.

Theksoi mungesën e tabelave kufizuese të shpejtësisë në hyrje të fshatit.

Kërkoi ndërhyrje ndaj kompanisë së ujësjellësit që dëmton rrugët dhe nuk i rikthen në gjendjen e mëparshme.

Skender Ademi,

Kërkoi riparimin e urës në lagjen Tasholli, ku kabllot janë të ekspozuara.

Theksoi nevojën për mirëmbajtjen e barit përgjatë rrugës.

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti sqaroi disa nga çështjet e ngritura,

Ritheksoi rëndësinë e rritjes së buxhetit për mirëmbajtje, pasi projektet kapitale ekzistuese kërkojnë mirëmbajtje të rregullt.

Çështja e urave do të trajtohet si investim kapital.

Shtrati i lumit është kontraktuar për rregullim, por kompania nuk i ka përmbushur detyrimet dhe komuna është në proces të ndërmarrjes së hapave për zgjidhje.

Për stadiumin, komuna ka ndarë një parcelë dhe nëse nuk realizohet ndërtimi i plotë, do të investohet së paku në rinovimin e fushës ekzistuese.

Rrugët bujqësore të kategorisë së katërt janë zhavorruar këtë vit dhe planifikohet që të mbulohen edhe vitin e ardhshëm.

Ndër çështjet më kritike janë menaxhimi i mbeturinave dhe furnizimi me ujë. Kompania e pastrimit është në prag të falimentimit dhe komuna është në proces të gjetjes së një zgjidhjeje alternative.

Komuna nuk ka më përfaqësim në bordet e kompanive të ujësjellësit dhe energjisë, që po shkaktojnë dëme pa marrë përgjegjësi për rregullimin e tyre.

Adil Hashani,

Kërkoi asfaltimin e rrugëve deri te gurthyesit.

Kërkoi mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe vendosjen e një table ndaluese për mbeturina në varrezat e Drangollës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Driton Shabiu,

Kërkoi rinovimin apo ndërtimin e një palestre të re sportive, pasi ekzistuesja është në gjendje të keqe dhe po pikon.

Rexhep Rexhepi,

Kërkoi asfaltimin e rrugës nga Gadimja deri të lagjja Ejupi deri të rruga për Smallush.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028

Data: 11.06.2025

Ora: 17:00

Vendi: Shkolla Fillore në Grackë të Vjetër

Takimi i gjashtë: Qytetarët e Grackës së Vjetër

Numri i pjesëmarrësve: 5

Burra: 5

Gra: 0

Prezantimi i Buxhetit:

Gjate këtij takimi është bërë prezantimi dhe planifikimi i buxhetit të komunës së Lipjanit duke i falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e parë për kornizën afatmesme buxhetore 2026 – 2028 me thekës të veçante investimet kapital dhe investimet tjera të cilat do të bëjë komuna për gjate viteve 2026 – 2028.

Diskutimet:

Zoran Cirkovic,

Si kërkesë është asfaltimin e rrugicave në fshatin Grackë,

Kërkesa tjetër është mirëmbajtja e ndriçimit publik pasi që disa drita janë prish dhe kërkojmë që të riparohen ose të ndërrohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028

Data: 11.06.2025

Ora: 18:00

Vendi: Shkolla Fillore “Dy Dëshmorët” Dobrajë e Madhe

Takimi i gjashtë: Qytetarët e Dobrajës së Madhe

Numri i pjesëmarrësve: 36

Burra: 31

Gra: 5

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjate këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka bërë prezantimin e planifikimit të buxhetit të komunës së Lipjanit duke i falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e parë për kornizën afatmesme buxhetore 2026 – 2028 me thekës të veçante investimet kapital dhe investimet tjera të cilat do ti bëjë komuna për gjate viteve 2026 – 2028.

Latif Ramadani falënderoi qytetarët për rritjen e të hyrave buxhetore si rezultat i kryerjes së obligimeve tatimore ndaj komunës, duke theksuar se këto të hyra po kthehen në investime në projekte të rëndësishme për komunitetin.

Diskutimet:

Skender Gashi,

Përfaqësues i fshatit, theksoi se ndonëse janë realizuar disa punë në Dobrajë, nevojat mbetin të shumta. Ai kërkoi:

Asfaltimin e rrugicave në fshat.

Albert Bublica kërkoi,

Ndërtimin e një çerdheje,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Saud Publica,

Rexhep Bahtiri kërkoi pastrimin e lumit të fshatit dhe subvencionimin e fermerëve lokalë.

Propozoj që të subvencionohen fermer sepse është tejet e rëndësishme kjo edhe pse komuna vazhdimisht po mbështet fermerët.

Bleart Halili,

Zgjerimin e rrugës në drejtim të Dobrajës së Vogël dhe Medvecit dhe ndërtimin e trotuarit për shkak të qarkullimit të lartë të automjeteve.

Nazmi Krasniqi,

Zgjerimin e rrugës që shpie drejt Medvecit.

Asfaltimin e rrugicave në Dobraje të Vogël.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

PROCESVERBAL

Dëgjimet Publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028

Data: 11.06.2025

Ora: 19:30

Vendi: Shkolla Fillore “Katër Dëshmorët” Krojmir

Takimi i shtatë: Me qytetaret e Krojmir

Numri i pjesëmarrësve: 32

Burra: 32

Gra: 0

Prezantimi i Buxhetit:

Drejtori për Buxhete dhe Financa, Latif Ramadani,

Gjate këtij takimi drejtori për Buxhet dhe Financa ka bërë prezantimin e planifikimit të buxhetit të komunës së Lipjanit duke i falënderuar për pjesëmarrjen në takimin e parë për kornizën afatmesme buxhetore 2026 – 2028 me theks të veçante investimet kapital dhe investimet tjera të cilat do të bëjë komuna për gjate viteve 2026 – 2028.

Diskutimet:

Sinan Qeriqi, kryetar i fshatit,

Falënderoi për pjesëmarrjen dhe ftoi qytetarët të ndajnë nevojat e tyre pa hezitim.

Ridvan Olluri,

Nga lagjja Ollurët, kërkoj që të mirëmbahet ndriçimi publik sepse ka disa drita nuk po funksionojnë.

Imer Qeriqi,

Kërkoj përfundimin e punimeve të kanalizimit që kanë mbetur në gjysmë.

Veton Qeriqi theksoi se:



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Kapaciteti i furnizimit me ujë është i ulët dhe nuk zgjat më shumë se një orë. Kërkoi ndërhyrje për rritjen e kapacitetit.

Hamdi Qeriqi,

Kërkoi rregullimin e urave në fshat.

Driton Rizani,

Kërkoi rregullimin e kanalizimit në fshat.

Sinan Qeriqi theksoi se prioriteti i parë për fshatin Krojmir është përfundimi i kanalizimit.